

Banka e Shqipërisë

ANALIZË E ZHVILLIMEVE
NË SEKTORIN E JASHTËM
TË EKONOMISË

TREMUJORI III - 2017

ENIAN ÇELA
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

JANAR 2017

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P E R M B A J T J A

<i>I. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE</i>	4
<i>II. LLOGARIA KORRENTE</i>	5
<i>III. LLOGARIA KAPITALE</i>	10
<i>IV. LLOGARIA FINANCIARE</i>	13

I. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE¹

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 133.1 milionë eurosh në tremujorin e tretë të vitit 2017, duke u ngushtuar me rreth 10.5% në nivel vjetor. Ai u vlerësua në nivelin 4.6% ndaj PBB-së nominale, ose rreth 1.0 pikë përqindjeje më i ulët se i njëjti tremujor i një viti më parë. Sipas zërave përbërës të llogarisë korrente, kontributi në kahun ngushtues është i lidhur me zgjerimin e tepricës pozitive të llogarisë së shërbimeve, dhe pjesërisht për shkak të të ardhurave dytësore. Në rastin e shërbimeve, ndikimi pozitiv është lidhur fortësisht me nënlogarinë e "Shërbimeve të tjera të Biznesit", me ndikime pozitive edhe nga shërbimet e udhëtimit.

Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve shënuan rritje prej rreth 19.8% në nivel vjetor, ndikuar në masë të madhe nga zgjerimi vjetor i eksportit të shërbimeve me 22.8%. Gjithashtu, eksporti i mallrave u zgjerua me rreth 10.0%. Importi i përgjithshëm u zgjerua me rreth 10.9% në terma vjetorë, me kontribute kryesore nga importi i mallrave, i zgjeruar me rreth 10.0% krahasuar me një vit më parë. Importi i shërbimeve gjithashtu përjetoi një rritje të shpejtë prej 12.6%, ndikuar kryesisht nga shërbimet dalëse të turizmit. Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, bilanci i përgjithshëm tregtar i mallrave dhe shërbimeve u ngushtua me 9.1% në terma vjetorë, me ndikim kryesor nga zgjerimi i suficitit të llogarisë së shërbimeve me rreth 41.3%. Nga ana tjetër, deficitit tregtar i mallrave u zgjerua me 6.5%.

Suficiti i llogarisë së të ardhurave dytësore u zgjerua me 0.9% në nivel vjetor. Remitancat neto u zgjeruan me rreth 3.9%. Për sa i përket llogarisë së të ardhurave parësore, teprica pozitive u ngushtua me 8.6%, e ndikuar kryesisht nga rritja e të ardhurave dalëse nga investimet me 62.3%. Në të njëjtën kohë, të ardhurat hyrëse neto nga puna u zgjeruan me 5.7%, por kjo nuk ishte e mjaftueshme për të kompensuar ndikimin nga nënlogaria e të ardhurave nga investimet.

Flukset hyrëse neto në llogarinë kapitale shënuan vlerën 30.4 milionë euro dhe rezultuan rreth 27.4 milionë euro më të larta kundrejt të njëjtit tremujor të një viti më parë. Pozicioni neto në llogarinë financiare, tregon për një zgjerim të tepricës neto të detyrimeve me rreth 105.2% në nivel vjetor. Ndikimi kryesor në këtë dinamikë ka buruar nga pakësimi i fluksit të mjeteve të "Investimeve të Tjera" me rreth 73.2% (rreth 224.3 milionë euro). Ndërkohë, investimet direkte neto u zgjeruan me 1.1% në terma vjetorë. Në ndarjen e financimit të deficitit korrent sipas profilit të flukseve, kanë qenë flukset joborxhkrijuese ato me kontribut kryesor.

¹ Të dhënat më të fundit të bilancit të pagesave i përkasin tremujorit të tretë të vitit 2017. Duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2008, Banka e Shqipërisë harton Statistikat e Bilancit të Pagesave, në përputhje me standardet ndërkombëtare të parashikuara në Manualin e 6-të të Bilancit të Pagesave, publikuar nga FMN-ja. Ndryshimet kryesore mes metodologjisë aktuale dhe asaj të mëparshme sintetizohet në udhëzuesin e mëposhtëm:
http://www.bankofalbania.org/web/pub/shpjegues_per_ndryshimet_ne_publikimin_e_statistikave_te_sektorit_te_jashtem_sipas_bpm6_qershor_2014_2_6688_1.pdf
Për efekt analizash, të dhënat e Bilancit të Pagesave, nga viti 2002 deri në vitin 2007, u rriklasifikuan në përputhje me metodologjinë e re nga Departamenti i Politikës Monetare.

Flukset neto hyrëse në llogaritë kapitale e financiare arritën të mbulojnë 163.3% të deficitit të llogarisë korrente. Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një shtim të mjeteve të rezervës me rreth 37.6 milionë euro. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2017, stoku i rezervës valutore është në gjendje të mbulojë 6.5 muaj import mallrash dhe shërbimesh, ose 170% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto.

Tabelë 1. Tregues të bilancit të pagesave (të dhëna në milionë euro)


	T1 '16	T2 '16	T3'16	T4'16	T1'17	T2'17	T3'17
Llogaria korrente (në mil euro)	-197.7	-287.7	-148.6	-177.6	-150.4	-236.3	-133.1
vmv (%)	-5.6	148.7	-44.4	-39.0	-24.0	-17.9	-10.5
/ PBB-së (%)	-8.3	-10.3	-5.6	-6.2	-5.8	-7.7	-4.6
Mallra dhe shërbime	-403.3	-555.1	-410.9	-436.9	-311.8	-486.1	-373.7
vmv (%)	8.2	54.0	-13.7	-22.6	-22.7	-12.4	-9.1
Eksporte, f.o.b.	608.5	717.2	926.8	857.0	773.2	894.2	1110.1
vmv (%)	2.5	1.6	18.1	19.9	27.1	24.7	19.8
Importe, f.o.b.	1011.9	1272.3	1337.6	1293.8	1085.0	1380.3	1483.7
vmv (%)	4.7	19.3	6.0	1.1	7.2	8.5	10.9
Udhëtime neto	67.3	72.8	153.1	95.7	75.6	80.1	180.9
Të ardhura parësore	36.5	50.6	52.0	34.9	-7.6	36.4	28.4
Kredi	89.3	116.3	97.6	105.5	79.6	122.9	94.4
Debi	52.8	65.7	45.6	70.6	87.2	86.5	65.9
Të ardhura neto nga investimet direkte	-15.6	-36.2	-18.3	-26.8	-55.0	-62.8	-41.0
Të ardhura dytësore	169.1	216.8	210.3	224.4	169.0	213.4	212.2
Kredi	205.0	250.1	250.7	255.4	198.3	242.2	236.7
Debi	35.9	33.2	40.5	31.0	29.3	28.7	24.5
Dërgesa nga emigrantët -neto	135.7	153.8	159.6	165.4	135.1	162.7	165.8
vmv (%)	-4.2	-4.8	14.2	7.4	-0.5	5.7	3.9
Llogaria kapitale	6.6	7.2	3.1	49.4	23.8	25.3	30.4
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-191.2	-280.5	-145.5	-128.2	-126.6	-211.1	-102.6
Llogaria financiare	-139.1	-267.1	-91.0	-119.4	-290.7	-198.1	-186.8
vmv (%)	-6.0	65.5	-18.0	-38.9	109.0	-25.8	105.2
/ PBB-së (%)	-5.8	-9.6	-3.4	-4.2	-11.2	-6.4	-6.4
Investime direkte	-126.4	-250.9	-302.4	-256.7	-201.3	-217.6	-305.7
vmv (%)	-50.2	27.7	21.9	113.9	59.2	-13.3	1.1
Investime portofoli	111.1	-5.7	5.7	114.1	-137.5	-21.6	31.2
Derivativë financiarë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investime të tjera	-74.2	-10.5	261.7	-130.1	39.4	117.3	50.1
Mjetet e rezervës	-49.6	0.0	-56.1	153.3	8.6	-76.2	37.6
Gabime dhe harresa	52.1	13.4	54.5	8.9	-164.1	13.0	-84.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

II. LLOGARIA KORRENTE

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 133.3 milionë eurosh në tremujorin e tretë të vitit 2017, duke u ngushtuar me rreth 10.5% në nivel vjetor, normë kjo e ngadalësuar, krahasuar me tremujorët e mëparshëm (në 2017T2, deficitit korrent u ngushtua me 17.9% në terma vjetorë, ndërkohë që në 2017T1 u ngushtua me 24.0%). Ai u vlerësua në nivelin 4.6% ndaj PBB-së nominale ose rreth 1.0 pikë përqindje më ulët se i njëjti tremujor i një viti më parë. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit, raporti është 3.1 pikë përqindje më i ulët.

Në terma kontributesh, ngushtimi vjetor i deficitit korrent u përcaktua gjerësisht nga zgjerimi i suficitit të llogarisë së shërbimeve dhe lehtësisht nga të ardhurat dytësore. Nga ana tjetër, nënllogaritë e mallrave dhe të të ardhurave parësore kanë ndikuar në drejtim të zgjerimit të deficitit korrent.




Bilanci neto i llogarisë së shërbimeve regjistroi një zgjerim të suficitit të tij gjatë periudhës në analizë. Të ardhurat neto nga shërbimet rezultuan rreth 380.1 milionë euro, nga rreth 269.1 milionë euro që ishin në të njëjtin tremujor të një viti më parë, duke u rritur me rreth 41.3%. Dinamika e rritjes vjetore është përcaktuar kryesisht nga zgjerimi i eksportit të shërbimeve, me rreth 22.8% në nivel vjetor. Ndikimin kryesor në rritjen e eksporteve të kësaj kategorie e ka dhënë nënllogaria e “Shërbimeve të tjera të Biznesit”, eksportet e së cilës janë zgjeruar me rreth 214.6% në terma vjetorë. Kjo nënkategori është karakterizuar nga norma të shpejta të rritjes vjetore prej tremujorit të katërt të vitit të kaluar.

Në të njëjtën kohë, ndikime pozitive kanë buruar edhe nga nënllogaria e shërbimeve të udhëtimit të lidhura me aktivitetin turistik. Eksportet përkatëse u rritën me rreth 12.8%. Në këtë rast, norma e rritjes vjetore është ngadalësuar si në krahasim me tremujorin e kaluar (17.9%), ashtu edhe në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2016 (25.4%). Së fundi, kontribut të rëndësishëm në rritjen e eksportit të shërbimeve ka dhënë edhe kategoria e “Shërbimeve për përpunim të inpueteve fizike të zotëruara nga të tjerët”, e lidhur kjo me eksportin e lartë të produkteve tekstile gjatë periudhës në fjalë.

Në të njëjtën kohë, edhe importet e shërbimeve u shtuan me rreth 12.6% në terma vjetorë, me ndikim kryesor nga rritja e importeve të udhëtimit me rreth 10.7%. Në terma të PBB-së nominale, suficitit i llogarisë së shërbimeve u vlerësua në rreth 13.1%, me një rritje prej 3.0 pikësh përqindjeje krahasuar me një vit më parë dhe 6.3 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2017.


Grafik 2. Zërat kryesorë në llogarinë e shërbimeve (flukse neto në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në rastin e tregtisë së mallrave, zgjerimi i deficitit është shkaktuar kryesisht si pasojë e rritjes së shpejtë të importit të mallrave. Megjithë rigjallërimin e përgjithshëm që kanë përjetuar importet prej disa kohësh, rritja në këtë tremujor ka qenë edhe më e shpejtë, për shkak të rritjes së lartë të importeve të lëndës djegëse dhe energjisë elektrike. Kontributi i importeve të këtyre kategorive në rritjen e përgjithshme të importit të mallrave vlerësohet në nivelin 4.8 pikë përqindje. Në mungesë të këtij efekti, importi i mallrave do të zgjerohej me 5.2% (në vend të 10%) dhe deficitin e përgjithshëm tregtar të mallrave dhe shërbimeve do të ngushtohej me 19.0% (në vend të 9.1%). Në këto kushte, deficitin e llogarisë korrente do të shënonte vlerën 92.4 milionë euro dhe do të vlerësohej në nivelin 3.2% ndaj PBB-së nominale.


Grafik 3. Bilanci i të ardhurave parësorë (flukse neto, në milionë euro, majtas) dhe të ardhurat nga investimet direkte (flukse neto, në milionë euro, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bilanci neto i llogarisë së të ardhurave parësore rezultoi pozitiv. Flukset valutore neto në këtë llogari rezultuan në një suficit prej 28.4 milionë eurosh nga një suficit prej 52.0 milionë eurosh, që ishin në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Suficiti i regjistruar u vlerësua në rreth 1.0% ndaj PBB-së nominale, i përcaktuar kryesisht nga llogaria e të ardhurave nga puna. Nga ana tjetër, ngushtimi i suficitit të llogarisë në terma vjetorë është përcaktuar nga rritja e të ardhurave dalëse nga investimet.

Bilanci neto në suficit i llogarisë së të ardhurave dytësore është zgjeruar me rreth 0.9, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Suficiti përkatës u vlerësua në nivelin 212.2 milionë euro, ekuivalent me 7.3% të PBB-së nominale. Remitancat hyrëse dhanë kontribut në këtë ecuri, duke u zgjeruar me rreth 3.6% në nivel vjetor.



Të ardhurat neto kumulative nga llogaria e shërbimeve, e të ardhurave parësore dhe atyre dytësore, financuan rreth 82.3% të deficitit tregtar të mallrave. Ky raport është zgjeruar me 4.2 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2016 dhe 16.3 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e mëparshëm.


HAPËSIRË INFORMUESE: ZHVILLIMET NË HENDEKUN E KURSIMEVE DHE INVESTIMEVE

Hendeku kursime-investime i sektorit privat u ngushtua në terma vjetorë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2017, duke u vlerësuar në 3.2% ndaj PBB-së nominale. Ky raport është 0.9 pikë përqindje më i ulët me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Si kursimet private ashtu edhe investimet private janë pakësuar përsa i përket raportit të tyre ndaj PBB-së, por pakësimi i investimeve private ka rezultuar më i lartë. Raporti përkatës zbriti në 18.9% gjatë tremujorit në fjalë, krahasuar me 20.0% një vit më parë. Nga ana tjetër, raporti i kursimeve private ndaj PBB-së nominale u pakësua vetëm me 0.3 pikë përqindje, duke zbritur në 15.7%.

Në rastin e sektorit publik është vënë re gjithashtu një ngushtim i hendekut kursime-investime. Raporti për tremujorin e tretë të vitit vlerësohet në nivelin 1.4%, krahasuar me 1.5% një vit më parë. Ndikimi kryesor ka buruar nga zgjerimi i raportit të kursimeve publike nga 3.6% në 4.4%. Nga ana tjetër, edhe investimet publike kanë pësuar rritje në raport me PBB-në nominale, por kjo rritje ka rezultuar lehtësisht më e ngadaltë krahasuar me atë të kursimeve. Investimet publike u vlerësuan në 5.8% të PBB-së nominale, ndërkohë që një vit më parë ky raport shënonte 5.1%.

Në tërësi, si kursimet kombëtare ashtu edhe investimet kombëtare janë pakësuar në raport me PBB-në krahasuar me një vit më parë. Por kursimet janë pakësuar me një ritëm më të ngadaltë. Raporti i kursimeve kombëtare ndaj PBB-së u pakësua me 5.3 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke zbritur në nivelin 20.1%. Nga ana tjetër, raporti i investimeve kombëtare ndaj PBB-së u zvogëlua me 7.0 pikë përqindje në nivelin 24.7%.

Grafik 5. Diferenca vjetore në pikë përqindje ndaj PBB-së e treguesve të investimeve dhe kursimeve kombëtare (majtas), si dhe kontributi i tyre në ndryshimin vjetor të deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave


III. LLOGARIA KAPITALE

Llogaria kapitale regjistron në debi dhe në kredi të gjitha transaksionet për mjete/të mira jo të prodhuara – jofinanciare, si dhe transfertat kapitale² midis rezidentëve dhe jorezidentëve (për të cilat nuk ka një vlerë ekonomike në këmbim). Në tremujorin e tretë të vitit 2017, teprica pozitive e llogarisë kapitale ishte rreth 30.4 milionë euro, rreth 27.4 milionë euro më e lartë krahasuar me një vit më parë. Flukset kapitale neto në këtë llogari vlerësohen në 1.0% ndaj PBB-së nominale. Transfertat kapitale neto për llogari të “qeverisë së përgjithshme” ishin tepricë pozitive prej 13.0 milionë eurosh, ndërsa ato të “korporatave financiare dhe jofinanciare, ekonomive shtëpiake dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të ekonomive shtëpiake”, ishin 17.4 milionë euro.

Kombinimi i transaksioneve neto të llogarisë korrente dhe asaj kapitale jep pozicionin neto të ekonomisë vendase si huadhënës neto (suficit) dhe huamarrës neto (deficit), kundrejt ekonomive jorezidente. Në terma sasiorë, për tremujorin e tretë të vitit 2017, ekonomia jonë paraqet një pozicion neto huamarrës prej 102.6 milionë eurosh, i cili financohet nga llogaria financiare dhe zëri “gabime dhe harresa”. Ky pozicion rezulton 29.5% më e ulët krahasuar me një vit më parë dhe rreth 51.4% më e ulët krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2017.

IV. LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare regjistron një pozicion debitor prej 186.8 milionë eurosh për tremujorin e tretë të vitit 2017, me një zgjerim 105.2% ose 95.8 milionë eurosh krahasuar me një vit më parë. Prurjet valutore neto të kësaj llogarie u vlerësuan në rreth 6.4% të PBB-së nominale dhe financuan rreth 140.4% të deficitit korrent të regjistruar gjatë kësaj periudhe.




² Transfertat kapitale përfshijnë: 1. borxhin e falur; 2. pretendimet për sigurime dega jojetë; 3. grantet; 4. garancitë; 5. taksat (për trashëgimi, dhurata etj.); 6. transfertat kapitale të tjera.

Përcaktuesit kryesorë në zgjerimin e pozicionit debitor të llogarisë financiare ka qenë pakësimi i flukseve të mjeteve vendase me 41.9% ose rreth 104.7 milionë euro. Në të njëjtën kohë, edhe fluksi i detyrimeve të jorezidentëve është pakësuar me 11.4 milionë euro ose rreth 2.6% krahasuar me një vit më parë.


Në rastin e fluksit të mjeteve, ngushtimi është përcaktuar nga mjetet në formën e huasë të "Korporatave depozituese", të cilat janë pakësuar me rreth 129.6 milionë euro (pjesë e llogarisë së "Investimeve të tjera"). Në të njëjtën kohë, është pakësuar edhe fluksi i mjeteve në formën e "Monedhave dhe depozitave" në masën 104.6 milionë euro (rreth 51.7%). Si rezultat, teprica neto e mjeteve në "Investime të tjera" u pakësua me rreth 211.6 milionë euro ose rreth 80.8%.

Në rastin e detyrimeve, flukset e "Investimeve Direkte" mbeten përcaktuesi kryesor i nivelit të tepcës neto hyrëse të llogarisë financiare. Fluksi i detyrimeve të investimeve direkte ka mbetur pothuajse i pandryshuar krahasuar me një vit më parë (ritja vjetore vlerësohet në nivelin 0.4%). Sipas dekompozimit sektorial, është vënë re një kontribut pakësues i konsiderueshëm i lidhur me sektorin "Energjetik", ku mbizotërojnë projektet e mëdha (rreth 7.1 pikë përqindje), por ky pakësim është kompensuar pothuaj tërësisht nga sektorët e tjerë.



Në terma afatgjatë, investimet direkte përbëjnë një fluks valutor hyrës të rëndësishëm në financimin e deficitit korrent të vendit tonë. Për këtë tremujor, raporti i flukseve neto të investimeve direkte financoi rreth 229.7% të deficitit të regjistruar korrent. Ky raport ishte 26.3 pikë përqindje më i lartë se i njëjti tremujor i një viti më parë, dhe 137.7 pikë përqindje më i lartë krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Grafik 8. Përbërja e investimeve direkte (flukse, në milionë euro, majtas) dhe raporti i financimit të deficitit korrent prej investimeve direkte neto (djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Investimet e portofolit neto shënuan një tepricë neto të mjeteve prej 31.2 milionë eurosh, ndërkohë që një vit më parë shënonte 5.7 milionë euro. Dinamika është përcaktuar gjerësisht nga zgjerimi i mjeteve vendase me rreth 28.2 milionë euro. Ndërkohë, detyrimet u zgjeruan me rreth 2.6 milionë euro në terma vjetorë.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një shtim të mjeteve të rezervës në masën 37.6 milionë euro. Në fund të muajit shtator 2017, stoku i rezervës valutore ishte rreth 2.82 miliardë euro. Ky nivel ishte i mjaftueshëm për mbulimin e 6.5 muajve importi mallrash dhe shërbimesh dhe 170% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto.

Grafik 9. Gabime dhe harresa ndaj PBB-së nominale (në përqindje, majtas) dhe ndaj deficitit të llogarisë korrente (në përqindje, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Si pasojë e problemeve që mund të hasen në burimet e informacionit dhe gjatë hartimit të statistikave të sektorit të jashtëm, mund të ndodhë që bilanci i pagesave të ketë mospërputhje. Në statistikat e bilancit të pagesave, këto mospërputhje përmbledhen në zërin gabime dhe harresa, i cili llogaritet si "mbetje" (diferencë midis bilancit të llogarisë financiare dhe bilancit të llogarisë korrente plus bilancin e llogarisë kapitale). Për tremujorin e tretë të vitit 2017, llogaria "gabime dhe harresa neto" rezultoi në një fluks dalës prej 84.2 milionë eurosh dhe u vlerësua në 2.9% ndaj PBB-së nominale.

V. PROFILI I FINANCIMIT TË DEFICITIT KORRENT

Në profilin e financimit të deficitit korrent, është me rëndësi të monitorohet varësia ndaj flukseve hyrëse borxhkrijuese, kundrejt flukseve hyrëse më të dëshirueshme joborxhkrijuese³. Kështu, flukset financiare joborxhkrijuese nga investimet direkte neto dhe nga llogaria kapitale u vlerësuan në nivelin 11.6% ndaj PBB-së nominale. Këto ishin rreth 0.15 pikë përqindje më të larta krahasuar me një vit më parë. Flukset financiare borxhkrijuese u vlerësuan në nivelin -2.8% ndaj PBB-së nominale.

Pasi flukseve valutore neto borxhkrijuese dhe joborxhkrijuese në tërësi u shtohen edhe gabimet dhe harresat neto, përftohet masa e financimit të përgjithshëm të deficitit korrent. Këtë tremujor, raporti i financimit të llogarisë korrente ishte në nivelin 128.2%, duke u përkthyer në një shtim të mjeteve të rezervës me 37.6 milionë euro. Ky raport rezulton rreth 66 pikë përqindje më i lartë krahasuar me një vit më parë dhe 60.5 pikë përqindje më i lartë krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Grafik 10. Flukset hyrëse financiare borxhkrijuese dhe joborxhkrijuese ndaj PBB-së nominale (majtas) dhe financimi në total i deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



³ Kjo ndarje shërben për të monitoruar ndikimin që flukset financiare e kapitale kanë në borxhin e jashtëm të vendit. Flukset joborxhkrijuese përfshijnë Investimet Direkte dhe hyrjet neto të llogarisë kapitale, ndërsa flukset borxhkrijuese përfshijnë investimet e portofolit dhe investimet e tjera neto.